



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE  
SEKTORI I TURIZMIT, RINISË DHE INTEGRIMIT NË BE

Nr. 4004 prot.

Gramsh, më 16/09/2024

RELACION

PËR

"MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË  
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË  
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ

KËSHILLIT BASHKIAK ✓  
GRAMSH

**Të nderuar Këshilltarë!**

Këshilli Vendor i Rinisë është një organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Ky këshill do të shërbejë si një model i ri i përmirësimit të statusit shoqëror dhe pozitës së të rinjve/rejave, i cili i shërben mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të tyre.

Do të mundësohet fuqizimi i të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre aktive në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse, gjë që siguron dhe një rritje të tyre në këtë pjesëmarrje. Po kështu do të garantohen hapësira rinore të sigurta, ku të rinjtë mblidhen, angazhohen në veprimtari që u përshtaten nevojave të tyre të larmishme, bëhen aktorë dhe faktorë të rëndësishëm në proceset vendimmarrëse, përmes një angazhimi të tyre në çështje të rëndësishme, që lidhen me qeverisjen vendore, pjesëmarrjes në veprimtari kulturore, sportive, argëtuese në komunitet, në hapësirat digjitale, që i ndihmojnë të rinjtë të ndërveprojnë virtualisht me njëri-tjetrin brenda e jashtë vendit. Në këtë drejtim me mjaft rëndësi është plotësimi i nevojave, sidomos të atyre nga grupet vulnerable ose të marginalizuar.

Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 6 (gjashtë) anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë do të bëhet duke ju referuar kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë. Me vendim të Këshillit Bashkiak do të përcaktohen kriteret e përzgjedhjes të vendosura në Vendimin

e Këshillit të Ministrave Nr.969 datë 02.12.2020 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të tij".

Për këto arsye, Ju ftojme që të votoni projekt- vendimin e paraqitur.

**PËRGJEGJËS I RINISË, TURIZMIT DHE  
INTEGRIMIT NE BE  
BLERINA SINANI**



**KRYETARI  
BESION AJAZI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE  
SEKTORI I TURIZMIT, RINISË DHE INTEGRIMIT NË BE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Gramsh, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024

### A. Historiku i Këshillit Rinor Vendor Gramsh

Këshilli Rinor Vendor Gramsh është një sektor i ideuar dhe i mbështetur nga Bashkia Gramsh, i cili ka për qëllim përkrahjen, konsulencën, aktivizmin vullnetarizmin dhe zhvillimin e lidershit për rininë e qytetit. Gjithashtu, ky sektor synon ndërtimin e marrëdhënieve midis të rinjve dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal e qëndror, OJF-ve, etj. Për të qënë pjesë e këshillit rinor nuk kërkon asnjë lloj kostoje monetare nga ana e të rinjve, mjafton që këta të fundit të aplikojnë dhe të kenë dëshirë për të përfaqësuar zërin e bashkëmoshatarëve të tyre në çështjet rinore.

Proçesi i aplikimit të të rinjve realizohet përgjatë 45 (dyzet e pesë) ditëve. Fillimisht hapet thirrja për aplikim, e cila qëndron e hapur për 30 (tridhjetë) ditë. Më pas grupi i ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë, kryen përzgjedhjen e kandidatëve dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të publikojë rezultatet dhe të njoftojë kandidatët e përzgjedhur. Proçesi i përzgjedhjes do bazohet në cilësinë e aplikimit të çdo aplikanti, shprehjen e interesave, nivelin e anglishtes dhe në letër rekomandimet që ata do të sjellin. Komisioni i përzgjedhjes do përpiqet të krijojë një grup me një mesatare moshe, përkatësie gjinore dhe nga pjesë të ndryshme të qytetit.

Pas kësaj, organizohet mbledhja e parë me kandidatët e përzgjedhur dhe përfaqësues të Bashkisë Gramsh, ku prezantohen të përzgjedhurit dhe detyrat/angazhimet që lindin, nga të qënurit pjesë e Këshillit Rinor Vendor Gramsh.

**1-31 Gusht :** Faza e aplikimeve, dorëzohen formularët deri në datë 31.08.2024 orën 14:00 pranë Bashkisë Gramsh.

**1-10 Shtator :** Komisioni i ngritur realizon proçesin e selektimit duke marrë në shqyrtim të gjitha aplikimet dhe bën përzgjedhjet

**15 Shtator:** Të përzgjedhurit njoftohen dhe bëhet prezantimi i çdo detaj tjetër në lidhje me Këshillin Rinor Vendor Gramsh.

## **B. Proçedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Rinor Vendor Gramsh.**

### *1. Përbërja e Këshillit Rinor Vendor Gramsh*

Numri i anëtarëve të Këshillit Rinor Vendor është 7 (shtatë), prej të cilëve:

- 1 (një) Kryetari i Bashkisë - i cili do jetë kryetari i Këshillit Rinor Vendor,
- 4 (katër) përfaqësues nga shkollat e mesme, 2 (dy) prej të cilëve femra dhe 2 (dy) meshkuj;
- 2 (dy) përfaqësues nga organizata rinore dhe/ose për të rinjë.

### *2. Kriteret e përzgjedhjes*

❖ Kandidatët për anëtar të përzgjedhur nga shkollat e mesme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të kenë dhënë kontribut në fushën e rinisë;
- b) Të jenë të rinj me mesatare mbi 8-të;
- c) Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi, dhe ide novative;
- d) Të jenë të gatshëm të punojnë në grup,
- e) Të mos kenë konflikt interesi.

❖ Kandidatët për anëtar të përzgjedhur përfaqësues të organizatave rinore, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme.

- a) të jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
- b) të mos jetë i dënuar,
- c) të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
- d) të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në Këshillin Vendor Rinor.

### *3. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim*

Kandidatët për t'u emëruar anëtar i Këshillit Rinor Vendor Gramsh duhet të paraqesin përkatësisht dokumentacionin si vijon:

❖ Kandidatët nga shkollat e mesme:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) jetëshkrim;
- c) fotokopje të dokumentave që vërtetojnë jetëshkrimin;
- e) letër interesi/motivimi;
- d) vërtetim të gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimit të saj,
- f) vetëdeklarimin lidhur me shmangien e konfliktit të interesave.

- ❖ Kandidatët përfaqësues i organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:
  - a) kërkesë me shkrim ku të shpreh interesin për aplikim;
  - b) jetëshkrim;
  - c) fotokopje të dokumentave që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
  - d) vërtetim të gjëndjes gjyqësore
  - dh) vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
  - e) referenca nga të paktën 2 bashkëpunorë të mëparshëm

### **C. Detyrat dhe detyrimet e Këshillit Rinor Vendor Gramsh**

1. Zbaton politikat dhe programet për të rinjtë;
2. Fokuson dhe siguron që çështjet që lidhen me rininë përfshijnë të gjitha fushat e veprimtarisë së Bashkisë.
3. Propozon Këshillit Bashkiak përmirësimin e politikave vendore si dhe programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në territor.
4. Harton, miraton dhe publikon thirrjet për projekt-propozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë.
5. Vleron gjëndjen e të rinjve dhe sa janë zbatuar politikat rinore vendore nga Bashkia, duke dhënë dhe rekomandime ose dhe sygjerimet përkatëse në funksion të përmirësimit të politikave rinore nga drejtoritë respektive në Bashki.
6. Harton, miraton dhe publikon thirrjet për projekt-propozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë;
7. Ndjek dhe zhvillon veprimtari rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, të mbrojtjes së mjedisit dhe edukimin joformal, si dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë.
8. Organizon takime, konferenca, fushata ndërgjegjësuere për përfshirjen e rinisë në jetën sociale, punësim e vendimmarrje.
9. Jep informacion ndaj të rinjve dhe/ose organizatave rinore për thirrjet për aplikime në projekte rinore të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë dhe atyre ndërkombëtare;
10. Ofron shërbime të ndryshme komunitare, nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve, për përmirësimin e jetës shoqërore në komunitetet e tyre;
11. Monitoron zbatimin e projekteve, që kanë përfituar mbështetje financiare.
12. Bashkëpunon me organizata të ndryshme rinore në nivel vendor, qendror dhe rajonal.
13. Ngre sipas nevojave grupe pune për çështje që lidhen me të rinjtë dhe përcakton përbërjen dhe rregullat e funksionimit të tyre.
14. Anëtarët e KRVG-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
15. Anëtarët e KRVG-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mosdiskriminimit, të meritës, transparencës e gjithëpërfshirjes.
16. Anëtarët e KRVG -së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Kryetarin e Bashkisë. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrit të ndryshimit.

**Përgjegjës i Rinisë, Turizmit**

**dhe Integritimit në BE**

**Blerina SINANI**

**KRYETARI**  
**Besion AJAZI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4904 prot.

Gramsh, më 16/09/2024

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_. \_\_\_\_ 2024

**PËR  
MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË  
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË  
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ.**

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2024 mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 21 pika 1 dhe 3, neni 22 si dhe neni 7, gërma "b" dhe pikës 3 të neni 10 të ligjit nr.75/2019 "Për rininë", neni 3, neni 4, neni 6 pika 2; neni 13 të ligjit Nr.8548 datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e kartës europiane të autonomis vendore" gërma "k", si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga specialisti i rinisë Bashkia Gramsh.

**VENDOSI**

1. Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të rinisë si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij.
2. Këshilli Vendor Rinor udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interes publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mos diskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.
3. Këshilli Vendor Rinor përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, ku respektohet parimi i barazisë gjinore dhe 1 (një) sekretar pa të drejtë vote.
4. Këshilli Vendor Rinor do të ketë në përbërje:
  - a) Kryetari i Bashkisë, (kryetar)
  - b) Përfaqësues i Këshillit Bashkiak ose administratës (sektori i rinisë) (sekretar)
  - c) 2 (dy) përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtar).
  - d) 4 (katër) përfaqësues nga të rinj aktiv të Qytetit ose të Njësive Administrative (anëtar).
5. Anëtarët e Këshillave Vendor Rinor emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është 2 (dy) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

6. Anëtarët e Këshillave Vendor Rinor mund të japin dorëheqjen duke njoftuar me shkrim kryetarin. Kryetari mund të vendosë edhe për përjashtimin e ndonjë anëtari në rast të mos paraqitjes në takime për më shumë se 2 (dy) herë rradhazi ose në raste të tjera të mos përmbushjes së funksioneve, anëtari zvendësues plotëson mandatin e anëtarit që zvendëson.

7. Anëtarët e Këshillave Rinor identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirje për shprehje interesi për të marrë pjesë në Këshillin Rinor Vendor, të hartuar e njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

8. Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes nga këshilli bashkiak dhe/ose administrata vendore, kryhet nga kryetari i bashkisë, duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projektet që lidhen me të rinjtë.

9. Përzgjedhja mes kandidatëve përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë, bëhet komisioni vlerësues i ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
- b) të mos jetë i dënuar;
- c) të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
- d) të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në Këshillin Vendor Rinor.

10. Kandidatët për Këshillin Vendor Rinor, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

- a) kërkesë me shkrim ku të shpreh interesin për aplikim,
- b) jetëshkrim;
- c) fotokopje të dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit,
- d) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- dh) vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
- e) referenca nga të paktën 2 bashkëpunorë të mëparshëm.

11. Kandidatët për Këshillin Vendor Rinor, përfaqësues nga të rinj aktiv duhet të përmbushin këto kriteret;

- a) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) të jetë përfshirë në organizimin apo në zbatimin e aktiviteteve rinore, apo në promovimin e të rinjve;
- c) të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në Këshillin Rinor Vendor.



12. Kantidatët për Këshillin Vendor Rinor, përfaqësues nga të rinj aktiv të Njesisë Administrative duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) jetëshkrim;
- c) fotokopje të dokumentave që vërtetojnë jetëshkrimin,
- d) vërtetim të gjëndjes gjyqësore ose vetëdeklarimit të saj,
- dh) letër interesi/motivimi;
- e) vetëdeklarimin lidhur me shmangien e konfliktit të interesave

13. Këshilli Vendor Rinor mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari i Bashkisë.

14. Veprimtaria e Këshillit Vendor Rinor mbështetet nga sekretari teknik, që është një punonjës i bashkisë i ngarkuar nga kryetari me këtë detyrë.

15. Sekretari teknik njofton anëtarët e Këshillit Vendor Rinor jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para për datën dhe orën e takimit si dhe rendin e ditës. Sekretari teknik mban minutat e takimit dhe çdo komunikim tjetër që lidhet me veprimtarinë e Këshillit Vendor Rinor.

16. Mbledhjet e Këshillit Vendor Rinor zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 3 (tre) anëtarë. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimali anëtarve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.

17. Ngarkohet Kryetari Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

18. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**SEKRETARI I KËSH. BASHKIAK**  
**XHULIA GJINI**

**KRYETARI I KËSH. BASHKIAK**  
**ENIS ZANI**

